



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:256939

Datë: 07.08.2020

Numri i dokumentit: 01054340

P.nr.1026/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – Departamenti i Përgjithshëm në Pejë, sipas gjyqtarit Murat Hulaj, me praktikante Edita Ferati, në lëndën penale kundër të pandehurit S S nga fshati...tani me vendbanim ne rr..., Komuna e Pejës, i akuzuar për shkak të vepër penale, **Vjedhje e shërbimeve**, parashikuar nga neni 314 par. 1, të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr. 2427/19 e dt. 04.11.2019 në Pejë, e duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, të Prokurorisë Themelore në Pejë, të dt.18.02.2020, me dt. 07.08.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e dt. 18.02.2020, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor e Prokurorisë Themelore në Pejë sipas aktakuzës PP.II.nr. 2427/19 e dt. 04.11.2019.

I pandehuri,

S.S, i lindur me 11.03.1980, ne fshatin ...tani me vendbanim ne rr..., Komuna e Pejës, nga babai B. dhe nena SH. e gjinisë SH, i martuar, i identifikuar me nr. personal ..., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me parë dhe gjerë me date 09.01.2018 ne K. Peje, pikërisht ne shtëpinë e tij me qëllim të përfitimit ne mënyre te kundërligjshme është furnizuar me energji elektrike ne mënyrë qe gjatë kontrollimit nga komisioni i autorizuar i K..., ditën kritike është hasur ne ndërrim te njësorit nga mekanik ne digjital ku ne njësorin e vjetër vëreheshin gjurme te shiritit filmik ne anën e djathte te xhamit. Për ta vërtetuar gjendjen faktike njëtori dërgohet ne laborator ku me dt. 20.01.2019 komisioni ka konstatuar se njëtori elektrik pllombat i ka ne rregull, nga ana e jashtme nuk vërehen dëmtime, mirëpo ne brendi te njësorit përreth qelqit nga ana e djathte është futur shiriti filmik, e qe ishte penguar puna e diskut, ashtu qe pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike me pajisjet e përshkruara si ne procesverbalin me nr.... me ç’ rast të dëmtuarës K... i shkakton dem material te konsiderueshëm.

- me çka ka kryer vepër penale, *Vjedhje e shërbimeve*, parashikuar nga neni 314 par. 1, të KPK-së.

Andaj gjykata konfirmo neni **34,36, 39, 64 par. 1, dhe 314 par.1 të KPK-ës, e lidhur me neni 495 par 1,2,3 të KPPK-së të pandehurit i shqipton,**

DËNIM ME GJOBË

- I. Ashtu që ia përcakton dënimin me gjobë në lartësi **prej 100 (njëqind) €** , të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të paraparë në pikën **I**, të këtij dispozitivi, gjykata do ta bëjë zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi prej 5(pesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgimi, për çdo 20 euro të gjobës.
- III. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave shumen prej 30 (tridhjetë) euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjënë shpenzime të tilla.
- IV. E dëmtuara K..., për realizimin e kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTH në Pejë, ka ushtruar aktakuzë PP.II.nr. 2427/19 e dt. 04.11.2019, kundër të pandehurit S S nga fshati ... tani me vendbanim ne rr. Komuna e Pejës, i akuzuar për shkak të vepër penale, *Vjedhje e shërbimeve*, parashikuar nga neni 314 par. 1, të KPRK-së, dhe ka kërkuar nga gjykata që kundër të njëjtit të caktohet dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor, ku i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

PTH në Pejë, në ndërkohë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor me nr. PP/II PP.II.nr. 2427/19 e dt. 18.02.2020, kundër te pandehurit S S nga fshati ..., tani me vendbanim ne rr..., Komuna e Pejës, i akuzuar për shkak të vepër penale, *Vjedhje e shërbimeve*, parashikuar nga neni 314 par. 1, i KPRK-së ,duke propozuar, qe ndaj të pandehurit, të shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata, gjatë vlerësimit të kërkesës, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor, ka gjetur se kërkesa për dhënien e Urdhrit ndëshkimor, PP/II PP.II.nr. 2427/19 e dt.18.02.2020 **është e bazuar.**

Me parë dhe gjerë me date 09.01.2018 ne K. Peje, pikërisht ne shtëpinë e tij me qëllim të përfitimit ne mënyre te kundërligjshme është furnizuar me energji elektrike ne mënyrë qe gjatë kontrollimit nga komisioni i autorizuar i K..., ditën kritike është hasur ne ndërrim te njësorit nga mekanik ne digjital ku ne njësorin e vjetër vëreheshin gjurme te shiritit filmik ne anën e djathte te xhamit. Për ta vërtetuar gjendjen faktike njësori dërgohet ne laborator ku me dt. 20.01.2019 komisioni ka konstatuar se njësori elektrik pllombat i ka ne rregull, nga ana e jashtme nuk vërehen dëmtime, mirëpo ne brendi te njësorit përreth qelqit nga ana e djathte është futur shiriti filmik, e qe ishte penguar puna e diskut, ashtu qe pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike

me pajisjet e përshkruara si ne procesverbalin me nr. 0870749 me ç' rast të dëmtuarës K.... i shkakton dem material në lartësi prej 831.84 euro.

Gjendja faktike është vërtetuar me shikimin dhe leximin e procesverbaleve: procesverbal me numer 0870749 dt. 09.01.2018, procesverbal me numer 01/20 i dt.20.01.2018, fatura me numer DPEHP1811788 e dt. 23.01.2019, te dhënat për te pandehurën, si dhe te shikohen shkresat tjera ne lëndë.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje të thellë, se me te njëjtin do te arrihet qëllimi i dënimit, i parapara me nenin 38 të KPRK-së , duke vlerësuar se është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit , shkallën e rrezikshmërisë shoqërore , dhe në këtë mënyre do te ndikoj në arritjen e qiellit të dënimit, si masë për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë si kryes potencial të veprave penale në të ardhmen , të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, rritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi, mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim në rast dështimi për pagimin të gjobës, e mori në përputhje me nenin 43 par. 3 të KPK-së.

Gjykata ne bazë të nenit 453 të KPRK- së, ka obliguar të pandehurin që gjykatës t'ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë.

Gjykata në bazë te nenit 39 par. 3 nën par, 3.1 te ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit e ka obliguar të pandehurin në emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimit te paguaj shumen prej 30 euro.

Gjykata në baze te nenit 463 të KPK-së, të dëmtuarën K., e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike në shumë prej 831.84 euro, sepse në shkresa të lëndës e dëmtuara ka bashkangjitur një faturë të nxjerrë vetë, përmes të secilës kërkon dëmin.

Gjykata nuk e ka pranuar si provë të pranueshme ligjërishit faturën e përpiluar nga pala e dëmtuar, duke e konsideruar si të njëanëshe sepse është përpiluar nga e dëmtuara, dhe për këtë gjykata vlerëson se duhet bërë një ekspertizë nga një ekspert i pa varur për ta konstatuar dëmin real.

Nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1026/19 me dt.07.08.2020

Praktikante gjyqësore,
Edita Ferati

G j y q t a r i,
Dr.sc. Murat Hulaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri ka të drejtë të ushtroj kundërshtim, në afat prej 8 ditësh, gjyqtarit të kësaj çështje, e përmes zyrës së pranimit të kësaj gjykate.